

## RELACION TEKNIK

**Mbi objektin: "SISTEMIMI I RRUGEVE TE BRENDESHME TE FSHATRAVE  
"BLERIMAS, BAMATAT DHE STJAR " Bashkia Delvine.**

Projekti përfshin:

1. Sistemimi rrugeve te brendeshme te fshatit Blerimas
2. Sistemimi I rrugeve te brendeshme te fshatit Bamatat
3. Sistemimi I rrugeve te brendeshme te fshatit Stjar.

Amortizimi dhe gjendja e keqe e rrugeve te fshatrave. **Blerimas, Bamatat dhe Stjar** ka krijuar kushte të vështira kalimi për mjetet dhe këmbesorët prandaj është parë i domosdoshëm rikonstruksioni i këtyre rrugeve te cilet do të kene impakt në:

- Kushtet e jetesës së banoreve të fshatit
- Rivitalizimin e zonës përreth
- Zhvillimin ekonomik të kësaj zone

### **A. SISTEMIMI I RRUGEVE TE BRENDESHME TE FSHATIT BLERIMAS.**

#### **1. Rruga "SHEN NEKTARI" L=250ml B=3.0ml**

Sistemim i rruges "**Shen Nektari**" te fshatit te Blerimas, të Bashkisë Delvinë ka për qëllim të lehtësoj lëvizjen e banorëve dhe mjeteve të tyre.

Tabani i sheshit mbi të cilin do të shtrohet kërkohet të jetë i qëndrueshem (pa cedime të teperta dhe pa zhvendosje ) ndaj veprimit të ngarkesave të mjeteve lëvizese dhe i durueshem ndaj veprimit të agjentëve atmosferikë .

**Rruga ka gjatesi L = 2 50ml dhe gjeresi B = 3.0 ml**

Për realizimin e projektit fillimisht do të kryhen punime rafshim, skarifikim, nivelim me thellesi 10cm, pastaj një nën shtresë zhavori 10 cm te cilat do te ngjeshen me makineri dhe më vonë te shtrohet zgara e celikut Ø4mm, me permasa te kuadrateve 15x15 cm dhe beton M-200 me trashësi 12

Betoni dote jete I markes M-200 dhe do te kryhet ngjeshja me vibrator siperfaqesor.

Ne distancën 120ml vendoset një tombino  $\varnothing 300\text{mm}$  me gjatësi 4ml (mund të përdoret dhe tubacion i brinjëzuar plastik  $\varnothing 400\text{mm}$ ) së bashku me dy puseta hyrese e dalëse të nënkalimit ku për pusët do përdoret beton M-200 për trashësi të betonit të pusëtave  $t=12\text{cm}$ .

## **2. Sistemimi i Sheshit para Shkolles me shtresë cakelli të fraksionuar me $t=20\text{cm}$ me gjatësi $L= 80\text{ML}$ $B= 20.0\text{ML}$**

Për të krijuar një ambient sa më komod për shkollën, do të shtrohet me cakëll ose zhavor me permasa 80ml gjatësi dhe 10ml gjeresi dhe me trashësi 20cm të ngjeshur dhe të niveluar me makineri e cila kufizohet me murrin rrethues të shkollës dhe rrugës auto të mesit të fshatit Blerimas.

## **B, SISTEMIMI I RRUGEVE TË BRENDESHME TË FSHATIT BAMATAT**

### **1. Sistemimi i rrugës së "Bregut të Kuq" të fshatit Bamatat**

Sistemimi i rrugës së "Bregut të Kuq" të fshatit Bamatat, ka për qëllim të lehtësojë lëvizjen e banorëve që do të lëvizin në këtë segment rrugë..

Tabani i rrugës mbi të cilin do të shtrohet kërkohet të jetë i qëndrueshëm (pa cedime të tepërta dhe pa zhvendosje) ndaj veprimit të ngarkesave të mjeteve lëvizëse dhe i durueshëm ndaj veprimit të agjentëve atmosferikë.

Rruga ka një gjatësi  $L = 80\text{m}$ , gjeresi  $B=3.0\text{m}$ . sip. =  $240.0\text{m}^2$ .

Për realizimin e projektit fillimisht do të kryhen punime rrafshim, skarifikim, nivelim me thellesi 10cm, pastaj një nën shtresë zhavori ose gurë kave të copëtuara 10 cm të cilat do të ngjeshen me makineri dhe më vonë të shtrohet zgara e celikut  $\varnothing 4\text{mm}$ , me permasa të kuadratëve  $15 \times 15\text{ cm}$  dhe beton M-200 me trashësi 12 cm.

Betoni dote jete i markes M-200 dhe do të kryhet ngjeshja me vibrator sipërfaqësor.

Pas betonimit të sheshit do të kihet parasysh trajtimi i shtresës së betonit me ujë 2-3 here në ditë kjo sipas temperaturave të larta mbi 37 e 40 grade. Sikurse të kihet parasysh që për 15 ditë mbas betonimit nuk dote kalojnë makina të rrenda, sepse mund të demtojnë shtresën e betonit

### **2 Sistemimi i rrugës së depos së ujit "Petrit Isufi" Bamatat.** **Gjësia $L=180\text{ML}$ Gjereso $B=3.0\text{ML}$ Sip. = $540\text{m}^2$**

Për realizimin e kësaj rrugë fillimisht do të kryhen punime pastrimi të sipërfaqes së betonit të hedhur me parë i cili është demtuar, do të laget me ujë shtresa ekzistuese për të realizuar ngjitjen e betonit të vjetër me atë të riun, dhe do të shtrohet prapë me beton M-200 me trashësi 12 cm. (përpara i përket zgares së celikut  $\varnothing 4\text{mm}$  ajo është ekzistuese, sepse është shtruar kjo rrugë me përpara dhe zgara është).

Betoni dote jete i markes M-200 dhe do te kryhet ngjeshja me vibrator siperfaqesor

Nga kuota 00- 65ml do te hapet kanal me makineri dhe do te vishet me beton M-150 me trashesi te betonit  $t=6\text{cm}$ . Ne piketen 150ml eshte planifikuar nje tombino  $\varnothing 300\text{mm}$  me  $l=4.0\text{ml}$

Paralel me rrugen kryesore Sr-DI montohen 3cop tombino  $\varnothing 300\text{mm}$  me gjatesi sejcila  $L=4\text{ML}$ .

per sistemimin e ujrave te rruges nga ana e banesave familjare.Njekohesisht behet dhe germimi e pastrami dhe asistemimi I kanalit.

Pas betonimit te rruges dhe te kanalit te betonit do te kihet parasysh trajtimi I shtreses se betonit me uje 2-3 here ne dite kjo sipas temperaturave te larta mbi 37 e 40 grade.

### **3 Sistemimi I dy ure kanaleve qe te cojne ne fushen e sportit te fshatit Bamata**

**L1= 10ml B=5.5ml sip.=55m2**

**L2= 10ml B=5.5ml sip.=55m2.**

Për realizimin e kesaj rruge fillimisht do të kryhen punime nivelimi dhe pastrimi, pastaj, nën shtresë zhavori ose gurë kave të coptuar 10 cm per nivelim, dhe më vonë te shtrohet zgara e celikut  $\varnothing 4\text{mm}$ , me permasa te kuadrateve  $15 \times 15\text{ cm}$  dhe beton M-200 me trashësi 12 cm.

### **4.Sistemimi I rruges “Hulo Kseno”**

**L= 80ml b= 3.0ml sip.=240m2**

Për realizimin e kesaj rruge fillimisht do të kryhen punime rafshim, skarifikim, nivelim dhe mbushje te gropave te krijuara me thellesi 10cm, pastaj një nën shtresë zhavori ose gurë kave të coptuar 10 cm dhe më vonë te shtrohet zgara e celikut  $\varnothing 4\text{mm}$ , me permasa te kuadrateve  $15 \times 15\text{ cm}$  dhe beton M-200 me trashësi 12 cm.Ne fshatin Senc do te kryhen punime ne keto akse rruges.

Pas betonimit te rruges dhe te kanalit te betonit do te kihet parasysh trajtimi I shtreses se betonit me uje 2-3 here ne dite kjo sipas temperaturave te larta mbi 37 e 40 grade.

### **4. Sistemimi I rruges “Hetem Musai”**

**L=120ML B=3.0ML SIP.=360M2.**

Kjo rruge do te rifreskohet vetem me nje shtrese betoni,  $t=12\text{cm}$  sepse eshte shtruar njehere ,por eshte e demtuar dhe kerkon nje riveshje me beton me  $t=12\text{cm}$ . Ne kete rruge do te kryhet pastrami nga mbeturinat e dherave de te kuadratohet nga ted y anet me armature per te siguruar gjeresine e rruges  $b=3.0\text{ml}$ . do te kryhet lagia e rruges me uje, qe do te betonohet per te siguruar ngjitjen e betonit te ri me ate ekzistues.Gjate hedhjes se betonit te M-200 do te kryhet ngjeshja e tij me vibrator siperfaqesor,qe te jete sa me kompakt.

Pas betonimit te rruges dhe te kanalit te betonit do te kihet parasysh trajtimi I shtreses se betonit me uje 2-3 here ne dite kjo sipas temperaturave te larta mbi 37 e 40 grade.

## **. SISTEMIMI I RRUGEVE TE BRENDESHME TE FSHATIT STJAR.**

### **1.Sistemimi I rruges “Demo Emini”** (tek Baraka e Vodafonit)

**L=120ml b= 4.0ml sip.= 480 m2.**

Për realizimin e kesaj rruge fillimisht do të kryhen punime rafshim, skarifikim, nivelim me thellesi 10cm, pastaj një nën shtresë zhavori ose gurë kave të coptuar 10 cm dhe më vonë te shtrohet zgara e celikut Ø4mm, me permasa te kuadrateve 15x15 cm dhe beton M-200 me trashësi 12 cm.

Per sistemin e ujrave te shiut dhe te rruges do te kryhen punime germimi me makineri per kanal anesor nga te dy anet e rruges ne distance l=20-25ml ne fund te seksionit te rruges,e cila do te vishet me beton M-150 me trashesi t=8cm.

Ne te gjithë gjatesine e rruges do te shtrohet banakine zhavori e cakelli nga 1.0ml nga te dy anet e rruges se betonuar( pra: 2x1.0ml) me trashesi t=12cm, kjo per te bere qe gjithë gjerësia e rruges te jete e niveluar, dhe te jete lehtesisht e kalueshme per hyrje e dalje te makinave dhe banoreve te rruges, ku, nesor mund te shtrohet dhe me trotuar.

### **2.Sistemimi I rruges me trotuar nga Qendra e fshatit Stjar- pallati 4-katesh ne Rruget kryesore SR-DL.**

**L = 180 ML B = 2.0 ML**

Për realizimin e kesaj rruge fillimisht do të kryhen punime germimi dhe nivelimi te trotuarit te ndertuar ne krah te djathte te rruges duke u nisur nga Qendra e fshatit Stjar – sr.

Parashikohen te kryhen keto punime sipas preventivit te punimeve , dhe te perdoren betone M-200 per bordure e kunete ,dhe beton M-150 per shtresa ne trotuar. Per nderprerjet e trotuarit me rruge do te kihet parasysh qe bordura do te jete e shtrire per kalim te mjeteve. Trotuari do te kete nje pjeresi te njetrajteshme me gjatesine e rruges automobilistike.Shtresa e betonit te trotuarit do te kryhet me helicopter dhe me fshese me ngjyre.

### **3.Sistemimi I rruges “ RILINDJA”**

**L=150ML B= 3.0ML SIP. = 450M2**

Për realizimin e kesaj rruge fillimisht do të kryhen punime rafshim, skarifikim, nivelim me thellesi 10cm, pastaj një nën shtresë zhavori ose gurë kave të coptuar 10 cm dhe më vonë te shtrohet zgara e celikut Ø4mm, me permasa te kuadrateve 15x15 cm dhe beton M-200 me trashësi 12 cm.

Betoni dote jete I markes **M-200** dhe do te kryhet ngjeshja me vibrator siperfaqesor.

Pas betonimit te rruges do te kihet parasysh trajtimi I shtreses se betonit me uje 2-3 here ne dite kjo sipas temperaturave te larta mbi 37 e 40 grade.

**4. Shtrim rruge me asfaltobeton te unazes se fshatit Stjar** (kryqezimi I rruges per vorezat publike deri tek kruqezimi I rruges auto SR-DL.)

**L= 540ML B= 4.0ML**

Për realizimin e kesaj rruge fillimisht do të kihet parasysh se gjate viteve rruga ka krijuar nje taban te qendrueshem nga mbushjet me zhavor e cakell qe jane kryer gjate viteve te mepaeshme , dhe si pasoj do te vijohet me **nje shtrese cakelli t=10cm**, makadam te perhapur e ngjeshur me makineri, me vone me **nje shtrese stabilizanti t=5cm, binder me granil t=3.0cm** dhe shtrese asfaltobeton me zall lavatrice t=3.0cm me makineri.


Punime ne vepra arti ne rruge jane menduar per vendosjen e 2cop tombinove Ø400mm me gjatesi 5.0ml sejcila dhe, 2 cop tomb. Ø300mm me gjatesi 5.0m e 6.0m sejcila. Per te ruajtur rrugen e asfaltuar pergjate kanalit te shkarkimit te ujrave ne krah te shkolles" 9 vjecare" ,eshte parashikuar veshja e kanalit me beton nga njera ane .

Përsa përket **kushteve teknike të zbatimit (KTZ.)** për shtresat e zhavorit , shtresave të betonit, markave të betonit dhe zgarave te celikut, asfaltobetonit te jenë sipas standarteve të miratuara.

Sistemimi I këtyre segmenteve rrugore nuk cënon asnjë ndërtim apo pronë private .

Zyra e Planifikimit te Territorit

Ing. Kastriot MUSLLIMI



KRYETARI I BASHKISË

Rigels BALILI

